



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:082297

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05594336

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit M. P. M. S. , me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati shtetëror N. K., kundër të paditurit H. L., nga fshati ..., Komuna Kaçanik, për çështjen kontestuese kthimi i mjeteve, në seancën kryesore të mbajtur me datën 18.03.2024, në praninë e të autorizuarit të palës paditëse dhe të paditurit, ndërsa me datën 17.04.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T G J Y K I M**

**I. MIRATOHET**, në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, M. P. M. S. , me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET**, i padituri H. L., nga fshati ..., që paditësit të ja kthej mjetet financiare në shumë prej 90.00€

**II. DETYROHET** pala e paditur, që paditëses , t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, ndërsa kësaj gjykate shumë prej 20,00€, në emër të taksës për padi, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

I autorizuari i paditësit, si në padi, ashtu edhe në seancat përgatitore, ka kërkuar nga gjykata, që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të padituri që ta paguaj shumë prej 90.00€. Këtë pagë e ka kërkuar sepse pala paditëse, e ka pas një anëtar

të familjes të punësuar, i cili nga administrata tatimore, është identifikuar si tatim pagues, në administratën tatimore, ndërsa familja ka qenë shfrytëzues e ndihmës sociale.

Me nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, është paraparë në qoftë se një anëtar i familjes, është i punësuar, ai detyrohet të kthej pagesën e marrë, pa bazë ligjore. Po ashtu ka theksuar se kanë bërë përpjekje që këtë çështje ta zgjidhin me marrëveshje, por nuk kanë mundur

I autorizuari tutje ka theksuar, nga provat e ofruara, nga deklarata e të paditurit, vërtetohet se i padituri këto mjete i ka marrë pa bazë ligjore dhe ka obligim që këto mjete ti kthen, sipas Udhëzimit Administrativ numër 08/2010. Prandaj duke i marrë parasysh, këto fakte të konstatuara, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses, të miratohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

I padituri, padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi, i ka pranuar me datën 19.08.2020, dhe në afatin e paraparë ligjorë, nuk ka paraqitur përgjigje në padi. Në seancën përgatitore, ka deklaruar se e konteston krekës padinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzon, sepse nuk ka të ardhura për ta paguar këtë detyrim.

Po ashtu deklaroi, se ndihma sociale i është ndalë, e vendim të Qendrës për Punë Sociale, i cili fakte vërtetohet nga vendimi i datës 15.02.2019, dhe i është ndërprerë pa bazë ligjore, kinse djali i tij është i punësuar, por ka theksuar se i njëjti nuk jeton në bashkësi familjare me të paditurin.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqësve e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: U lexuan kërkesa për shfrytëzimin e ndihmës sociale, kërkesa për kthimin e mjeteve, deklarata e datës 24.01.2020, aktvendimi i datës 15.02.2019, formulari për përlllogaritjen e të mirave materiale, kërkesa për ndihmë sociale, lista e anëtareve të familjes, certifikata që nuk ka pronë, vërtetimi i tatimit në pronë, deklarata e bashkësisë familjare, certifikata e martesës, certifikata për anëtarë të familjes dhe deklarata e komisionit, pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi, dhe të secilës veç e veç, si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata me këtë çështje kontestimore juridiko- civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

I padituri ka qen shfrytëzues, i ndihmës sociale, kjo ndihëm ju ka ndërprerë, ndërsa ndihmën sociale për muajin Dhjetor të vitit 2019, e ka marrë pa bazë ligjore.

a) Se i padituri, ka qen shfrytëzues i ndihmës sociale, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga aktvendimi i datës 15.02.2019, ku është shënuar se aprovet kërkesa e H. L., nga fshati ..., për marrjen e ndihmës sociale. por ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

b) Të paditurit kjo ndihmë sociale, ju është ndërprerë, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga aktvendimi me numër të lëndës 13090, i datës 08,01,2020, ku në pikën I , është shënuar se i ndërpritet ndihma sociale familjare.

c) se i padituri ndihmën sociale, për muajin dhjetor të vitit 2019, e ka marrë pa bazë ligjore, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga thëniet në padi, provat të cilat gjinden në shkresat e lëndë ku është shënuar, se i padituri ndihmën sociale familjare për muajin Dhjetor të i viti 2019, e ka marrë në kundërshtim me Ligjinnr.2003/15, për ndihmën sociale në Kosovë, Ligjin Nr.-04/L-096, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ Nr.08/2019, për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesi i Skemës për Punë Sociale të fituara pa bazë ligjore.

Me nenet 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, është paraparë në qoftë se një anëtar i familjes, është i punësuar, ai detyrohet të kthej pagesën e marrë, pa bazë ligjore, e në rastin konkret është vërtetuar, se djali i të paditurit Z. H. L., nga fshati ... është identifikuar si tatim pagues në të hyra financiare nga Administrata Tatimore e Kosovës, në muajin Dhjetor të vitit 2019.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, theksimeve të palëve ndërgjyqës, të bëra gjatë këtij procesi gjyqësor, kërkesëpadinë e paditësit, e miratoi në tersi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën qe ta kthej shumën prej 90,00€, të marrë pa bazë ligjore . Me nenet 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, është paraparë në qoftë se një anëtar i

familjes, është i punësuar, shfrytëzuesi i ndihmës sociale detyrohet të kthej pagesën e marrë, pa bazë ligjore, e në rastin konkret është vërtetuar, se djali i të paditurit Z. H. L., nga fshati ..., është identifikuar si tatim pagues në të hyra financiare nga Administrata Tatimore e Kosovës, për Muajin Dhjetor të vitit 2019.

Gjykata i njofton palët me se me nenin 491.2 është paraparë se gjykata ka për detyrë që në aktgjykimin, përkatësisht aktvendimin nga paragrafi 1 të këtij neni, ti përmendë shkaqet në bazë të cilave mund të bëhet ankimi. Ndërsa me nenin neni 491.1, është paraparë se kundër Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël, mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar. Këto pretendime gjykata i analizoi dhe ua a fali besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. I padituri këtë shumë të mjeteve e ka marrë në kundërshtim e dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë çështje. I padituri këtë shumë e ka marrë në kundërshtim me Ligjinr.2003/15, për ndihmën sociale në Kosovë, Ligjin Nr.-04/L-096, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ Nr.08/2019, për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesi i Skemës për Punë Sociale të fituara pa bazë ligjore.

Po ashtu në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, me të cilën dispozit është paraparë në qoftë se një anëtar i familjes, është i punësuar, ai detyrohet të kthej pagesën e marrë, pa bazë ligjore, e në rastin konkret është vërtetuar, se djali i të paditurit Z. H. L., nga fshati ... është identifikuar si tatim pagues në të hyra financiare nga Administrata Tatimore e Kosovës, në muajin Dhjetor të vitit 2019

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të paditurit, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj në tëri si të pa bazuar, sepse nuk ka mjete për ta paguar dhe djali i tij në atë kohë ka qenë i ndarë dhe nuk ka jetuar me të paditurin. Gjykata këtyre theksimeve nuk u a fali besimin, sepse nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe. Gjykata në veçanti e ka analizuar pretendimin e të paditurit, se gjatë muajit Dhjetor të vitit 2019, i padituri nuk ka jetuar me djalin tij Z. L., por i padituri nuk ka prezantuar ndonjë provë- kontratë për shkëputjen e bashkësisë familjare, për ta vërtetuar këtë fakt.

Gjykata e detyroi palën e paditur, që kësaj gjykata të ja paguaj shumën prej 20,00€, në emër të taksës për padi(të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1, të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

C .nr.295/2020 prej datës 18.03.2024

Gjyqtari:

Riza Livoreka

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën 18.04.2024

Paditësit 1x1

Të paditurit 1x1